



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **24.05.2021** me fillim në ora **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete **z. Bajram Morina**. **Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete, përshëndes anëtarët e Komitetit për Komunitete, përshëndetje për drejtorin e Shëndetësisë, drejtorin e Arsimit, për përfaqësuesit e OSBE-së. Ky është takimi i dytë për vitin 2021, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

1. **Aprovimi i procesverballi nga mbledhja e kaluar;**
2. **Dëmtimi i varrezave serbe, shkatërrimi i përmendoreve në varrezat e vjetra të Rahovecit;**
3. **Formimi i komisionit për vizitë vendbanimeve dhe shkollave në Komunën e Rahovecit;**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – Të nderuar para se me qitë rendin e ditës në votim a keni diçka për të shtuar, nëse jo atëherë e qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Aprovimi i procesverballi nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka rreth Procesverballit të kaluar, atëherë nëse jo e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet Procesverballi nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Dëmtimi i varrezave serbe, shkatërrimi i përmendoreve në varrezat e vjetra të Rahovecit.

Darko Antiç – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë kam një pyetje për z. Fatmir Iska prej te cilit deshta me ditë çështjen e varrezave serbe lidhur me rrethimin e varrezave serbe edhe pse ekziston rruga dhe ne nuk kemi asgjë kundër asaj edhe sigurisht se rruga le të ekzistoj por është me rendësi të behet rrethimi i atyre varrezave dhe besojmë që rrethimi i varrezave sigurisht se ato nuk do të dëmtohen më pastaj, për arsye se ka mbi 3 muaj që nëna me ka vdekur që i është rregulluar përmendorja dhe tash shumë shpejt është shkatërruar ajo, kështu që ne si familje nuk po ndihemi të sigurt që përsëri me rregullua atë përmendore duke ditur që shumë shpejt mundet të dëmtohet përsëri ajo. Po ashtu e kemi edhe fenomenin e hedhjes së mbeturinave të ngurta brenda varrezave, kështu që kisha kërkuar një përgjigje nga nënkryetari z. Fatmir Iska.

Fatmir Iska – Përshëndetje për të gjithë. Hedhja e mbeturinave është një fenomen që ndodhë vazhdimisht në çdo vend ku ka varreza. Unë kam qenë me shumë se 5 herë për hapjen e asaj rruge për atë terrene dhe bashke me ata banor, kështu që edhe para se me qenë edhe shefi i zyrës për komunitete z. Lendrit Qeli edhe me përpara ka pasur tentime për rregullimin e saja rruge, pra vullneti dhe dëshira e komunës ekzistojnë por pengesa e vetme është përgjigja e dioqezës së Prizrenit dhe me pastaj edhe hierarkia e kishës ortodokse serbe kështu që deri me tani nuk kemi asnjë përgjigje. Unë po dua me përmend për një problem që ka ndodhur në vitin 2013 kur është hapur rruga për Zoqisht edhe është gërrye dheu që me u bo zgjerimi i saja rruge tek manastiri i Zoqishtit edhe pikërisht aty kemi pasur probleme me kadastrë edhe vërtetohet se deri në gjysmë të rrugës së shtruar me asfalt është pronë e kishës mirëpo me pajtimin e atyre është rregulluar, por meqenëse nuk kanë dhënë leje apo përgjigje në afat të caktuar kisha ortodokse serbe pasi nuk e di saktë

hierarkinë e tyre por e di që ne Prizren e kanë selinë dhe nuk kemi marr përgjigje por ne u deshtë me punue edhe kjo është përmend si problematike dhe ne Këshillë te sigurimit, pasi jam ne dijeni për këtë pasi me kanë kontaktuar edhe gazetaret e Novosit dhe Blic-it te Serbisë lidhur me këtë problematikë. Prandaj duke qenë kështu, në mënyrë që kjo mos te përsëritet edhe ne Këshillë te sigurimit si problematikë, në kërkojmë përgjigje për këtë, pasi ju kemi drejtuar edhe Fehmi Hoxhës sa ka qenë drejtor i Urbanizmit edhe unë sa kam qenë drejtor i Kadastrës edhe tash ju kemi drejtuar dy herë me shkresë që i kam në zyre dhe mundem edhe me ju argumentua, por prape nuk asnjë përgjigje prej kishës ortodokse serbe në mënyrë që ata te na lejojnë, për arsye se është pronë që e menaxhojnë ata me varreza dhe ne momentin që japin dritën e gjelbër atëherë ne si komunë jemi aty, ku përpos asaj rruge gjithashtu do te behet edhe hapja e rrugës që lidhet me rrugën Mizahir Isma apo siç e quajmë ne tek varri i baba Agushit që lidhet me atë pjesë dhe me pastaj kjo mund te rrethohet dhe te rregullohet që te mos këtë probleme mëtutjeshme. Pra këto janë informata apo takime që drejtpërsëdrejti jam marrë me këtë problematike por vetëm mungon përgjigja dhe ne momentin që ata na japin përgjigjen atëherë ne si komunë jemi te gatshëm me krye këtë punë për te mirën e varrezave dhe te gjithë qytetareve që te krijohet një rruge e re për qarkullim që ata banorë që jetojnë për me shume se 20 vjet që unë i njoh shumicën prej tyre aktualisht e shfrytëzojnë atë rrugë që kalon ka varrezat serbe në pjesën naltë mbi qytete.

Kryesuesi – Faleminderit nënkryetar, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, kalojmë ne pikën e radhës te rendit te ditës:

3. Formimi i komisionit për vizitë te vendbanimeve dhe shkollave në Komunën e Rahovecit.

Kryesuesi – Kisha deshtë me theksuar që vitin e kaluar nuk kemi pasur mundësi me dal ne teren në vizitë vendbanimeve ku jetojnë komunitetet për shkak te Covid – 19, kështu që e kam pa te arsyeshme me formua një komision që me dal për vizite vendbanimeve ku jetojnë komunitetet. Kështu që kisha kërkuar nga anëtarët e Komitetit që te dakordohen për formimin e komisionit.

Ali Zhuniqi – Përsëritet kryesues për ju dhe gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete. Më kujtohet sikurse sot ne vitin 2017, kur e patëm fillua mbledhjen e pare dhe pikërisht me të njëjtën pike te rendit te ditës kur e patëm diskutua ne raport me krijimin e e një komisioni për vizitë ne shkolla aty ku ka komunitete dhe kanë kalua gati 3 vite dhe nëse nuk gaboj ka qenë Prilli i vitit 2017 dhe nuk është ndërmarrë asgjë ne raport me atë që edhe ne e kemi vlerësuar te gjithë se bashku që me i bo këto vizita dhe që i kemi konsideruar që janë shume te nevojshme për komunitete te caktuara. Kështu që sot jemi ne te njëjtën pike ku prape vjen dhe unë për hire te se vërtetës nuk besoj që ka me ndodh diçka konkrete dhe ku qëndron problem nuk e di por ju si kryesues I grupit e mban përgjegjësin për gjithë këtë pjese dhe gjithë këtë rrugëtim ne kuadër te këtij komiteti për punët që nuk janë bërë, po ashtu ne kemi shprehur gatishmëri edhe si subjekt por edhe si grup por nuk është që kemi marr ne raport me atë që është prezantuar qysh nga viti 2017 dhe me pikat që vazhdimisht e kemi shprehur gatishmërinë për me punua se bashku. Kështu ne situatën që jemi tani pothuajse 6 muaj para fundit te mandatit, unë nuk besoj që mundemi me marr diçka hapa konkret duke pasur parasysh që tash edhe korniza afatmesme buxhetore do te diskutohet ne qershor dhe buxheti është I miratuar dhe ne mundemi të shkojmë vetëm formalisht me I vizitua që nuk do te kishte asnjë lloj problem por nuk do te thotë që kishim me marr ndonjë hap konkret ne raport me kërkesat e tyre.

Kryesuesi Bajram Morina – Pas formimit te komisionit nuk e di se a jeni ne ngjarje, ne kemi pasur vizita neper shkolla me shefin e zyrës për komunitet dhe drejtorin e DKA-së ne shkollën fillore Gëzim Hamza-Piktori ne Rahovec dhe kemi realizua atë vizitë, kështu që vitin e kaluar nuk kemi pasur mundësi për shkak te situatës se krijuar nga Covid-19 dhe për këtë arsye kam kërkuar që te formohet një komision ose le te jete ky komision dhe ne mundemi me vazhdua neper shkolla me I bo vizitat.

Ali Zhuniqi – Pa dashtë me u lëshuar ne polemika Bajram, z. Lendri Qeli është shef i zyrës për komunitete dhe ky ne cilësinë e shefit mundet të vije me na dhanë neve ndonjë informacion për kërkesat që atij i adresohen ne raport me komunitete te caktuara, kështu që drejtori i Arsimit nuk është pjesë e komisionit te cilin e përfaqëson me juve ne krye edhe si subjekte politike. Edhe koordinimin e punëve me atë që ju e thuani ju bini ne kundërshtim me krijimin e komisionit që keni krijuar, pasi që ne momentin kur ju keni dal për vizitë me Lendrit Qelin dhe drejtorin e Arsimit atëherë a mund te me thuani se cili është funksioni i komisionit për komunitete, qe d.m.th. se ne jemi te parëndësishëm për këtë punë dhe ju tani thuani se keni bërë një punë me drejtorin e Arsimit dhe shefin e zyrës për komunitete përkitazi me përgjegjësitë që ne i

kemi si komision atëherë ju bini ne kundërshtim me veten tuaj. Kështu që unë po mendoj se jemi shume vonë dhe ne kemi dhanë kontributin tonë 2017 dhe tash krejt këto janë një lloje makijazhi, pasi ju e keni krye atë punë me drejtorin e Arsimit dhe shefin e zyrës për komunitete dhe unë nuk besoj që tash ne këtë 6-mujorin e fundit mundemi me dhanë kontribut diçka rreth kësaj edhe meqenëse jemi ne fund te mandatit, pasi krejt këto tash me shume janë me shume politike për ndonjë fotografi që me pas mundësi me ju marr qeto vota dhe përfundon mandati, kështu që unë nuk mundem me qenë pjesë e këtij organizimi për shkak se ne vitin 2017 ne momentin kur kam qenë anëtarë dhe kam shprehur interesim me dhanë kontribut por fatkeqësisht për arsyet e juaja nuk keni mundur me i organizua këto punë dhe është ne përgjegjësinë e juaj.

Mirjeta Krasniqi – Faleminderit kryesues, atëherë unë po ndërlidhem ne fund, kisha me thënë që pasi jemi e njëjta legjislature dhe i njëjti komision duhet me krye punën që e ka lanë ne gjysme dhe ju i përmendi anëtarët e komisionit ekzistues atëherë nëse ka ndonjë mendim tjetër që me u tërheq dikush atëherë mundemi me pae se si janë mundësitë por i njëjti komision le te vazhdoj por vetëm duhet te i përmendi emrat. Po ashtu për vizitat për te ardhmen duhet te kontaktohen direkt që te mos këtë keqkuptime rreth kësaj pasi nuk është i autorizuar askush që të shkoj ne vend te anëtareve te komisionit që janë dhe kështu ata duhet te kontaktohen direkt dhe ta bëjnë vizitën aty ku duhet.

Bajram Morina – Faleminderit, atëherë unë kam listën e anëtareve te komisionit te formuar me herët, kështu që kisha propozua që me i lexue këta emra dhe nëse janë te pajtimt ata me vazhdua atëherë kishim vazhdua me te njëjtën listë. Anëtarët janë Ali Zhuniqi, Rame Berisha, Mirjeta Morina, Aleksandra Vuceviç dhe unë Bajram Morina. Pra ne kemi qenë 5 anëtar që keni propozua ju vet brenda komitetit për komunitete, kështu që nëse unë si kryesues atëherë si anëtare është edhe Aferdita Thaqi. Kështu që kisha kërkuar nga ju që te deklaroheni që ne momentin kur ju dërgoj ftesat, a keni mundësi për me dal ne vizita që me ditë saktë pasi kisha pas dëshira që sa me shpejt me i bo këto vizita pasi që pasi kanë filluar edhe masat e pandemisë me u lehtësua kështu e kisha pa te arsyeshme me dal brenda dhjetë dite.

Ali Zhuniqi – Nëse vërtet ka motiv për këtë edhe pse për veten time jam skeptik për këtë, pra nëse ka motiv që me u realizue kjo vizitë atëherë do te ishte mirë që ftesat kur te bëhen pasi që jemi te detyruar edhe ndaj punës tjetër edhe pse zyrtarisht me ligj na lejohet kur kemi mbledhje ne kuvend, do te ishte mirë që ftesat me u bo ne formën sikur që behën për mbledhje te kuvendit dhe te jenë te vulosura edhe prej kryesuesit qoftë qoftë ne kuadër te komiteteve. Nëse aktiviteti pretendohet që me u bo brenda 5 ditëve atëherë do te ishte mirë që ftesa me u bo për 5 ditë dhe nëse mendoni që aktiviteti duhet me u zhvillua ne 2 apo 3 jave atëherë ftesët duhet me i bo si i bëni tash ne kuadër te komitetit dhe planifikimi i vizitave sepse përndryshe do te kemi problem me marr leje nga puna e posaçërisht unë që punoj ne shëndetësi e kam paska me problem.

Rame Berisha – Përshëndetje për te gjithë anëtarët e komitetit dhe gjithashtu edhe bashkëpunëtorin e OSBE-së që është prezentë. Unë desha te ndërlidhem rreth kësaj edhe me raportua për dy pika. Nuk është mirë dhe nuk është kulturë për një vend që pa leje te dëmtohen monumentet historike, kultet fetare dhe varrezat pa marr parasysh përkatësinë etnike. Kështu që ata që i bëjnë këto vepra janë kundër kësaj shoqërie ne sistemin demokratik te Republikës se Kosovës. Këta njerëz na dërgojnë ne humbje dhe dëmtime te bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve. Prandaj organet e sigurimit dhe gjithë qytetarët duhet përkohësisht me u angazhua që me i gjete autoret dhe i qitë para drejtësisë. Pastaj sa i përket pikës se dyte, vërtet me vjen turp që me raportua apo me paraqit për një kërkesë qe edhe me përpara kam bërë kërkesë drejtorisë se shërbimeve publike 12.01.2021 që te rinovohen anësoret për siguri mbi një urë që është ne rrugën Elena Gjika ne Xërxe. Për kërkesën time janë dijeni i gjithë stafi komunal edhe sigurisht edhe ne anëtarët e komitetit për komunitete dhe rreth kërkesës sime ende nuk kemi ndonjë përgjigje dhe tani do ti drejtohem edhe me një kërkesë zyrës për komunitete dhe kthim, pasi renovimi i asaj ure ndihmon ne parandalimin e ndonjë fatkeqësie që mund ta pësojnë kalimtarët e rastit ne urën e cila ka lartësi deri ne 5 metra dhe që kalon një përrua aty. Kështu që nuk është ndonjë investim rreth atij renovimit duke pasur parasysh rrezikun permanent që ekziston ne atë urë.


Bajram Morina – Faleminderit baca Ramë, besoj që kërkesën e paske dergue ne vendin e duhur pra ne drejtorin e shërbimeve publike dhe po shpresoj që edhe ata do te përgjigjen pozitivisht rreth kërkesës suaj, që te ndërmerren masa për rregullimin e këtyre anësoreve. Atëherë nëse nuk ka dikush diçka sa i përket kësaj pike, kalojmë ne pikën e radhës:

4. Të ndryshme.

Atëherë meqë nuk kemi te lajmëruar për këtë pikë, konstatoj se takimi është i mbyllur dhe ju falënderoj për kontributin tuaj dhe shihemi ne takimin e radhës.

Procesmbajtësi

Agim Hoti

Kryesuesi i Mbledhjes

Bajram Morina

